



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2019:120846

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05375059

KE.nr.478/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit KEK Sh.A – Distrikti në Prizren, që sipas autorizimit përfaqësohet nga J.M. nga Prishtina, kundër të paditurit K.F. Liria – Stadiumi i Qytetit, me seli në Prizren, me objekt kontesti pagesë e borxhit, në seancën përgatitore të datës 26.02.2024 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit KEK Sh.A.- Distrikti Prizren kundër të paditurit KF LIRIA – Stadiumi i Qytetit, me objekt kontesti pagesë e borxhit, lënda e identifikuar me shenjën KE.nr. 478/22 (lidhja C.nr. 785/19).
- I. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

**A r s y e t i m**

Paditësi KEK Sh.A.- Distrikti Prizren, me datë 18.09.2008 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prizren, kundër të paditurës KF LIRIA – Stadiumi i Qytetit, me objekt kontesti pagesë e borxhit.

Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr. 717/13 të datës 03.02.2015, ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Ndërsa, duke vepruar sipas ankesës së paditësit, Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr. 1147/15 të datës 25.04.2019 e ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë shkallës së parë.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë është transferuar për vendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, në rivendosje, ka caktuar dhe mbajtur seancë përgatitore lidhur me këtë çështje juridike me datë 26.02.2024.

Në seancën përgatitore, nuk ka prezantuar paditësi, ndërsa nga fletë kthesa që gjendet në shkresat e lëndës rezulton se i njëjti thirrjen për seancë përgatitore e ka pranuar me datë 30.01.2024, mirëpo në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar. Ndërsa, në seancë ka prezantuar pala e paditur, e cila ka kërkuar nga gjykata që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr.

Andaj, nisur nga fakti se paditësi ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë dhe nuk ka prezantuar, ndërsa i padituri nuk ka pasur propozim që seanca të mbahet në mungesë të paditësit, gjykata duke u bazuar në nenin 409 paragrafin 1 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit KEK Sh.A.- Distrikti Prizren kundër te paditurit KF LIRIA – Stadiumi i Qytetit, me objekt kontesti pagesë e borxhit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 409 par.1 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 478/22, datë 26.02.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.